

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe  
siguria  
zgjidhjet**

**P10**

Data 08/07/2017

## Detyra 1

FreeSO Sh.A. është një kompani e madhe që operon në industrinë me pakicë, viti fiskal i të cilës përfundon me 31 dhjetor 2016. Ju jeni menaxher në firmën e auditimit Flutura & Partners, përgjegjës për auditimin FreeSO dhe sapo keni përfunduar takimin me Zenin, drejtorin financiar të kompanisë. Pasi që ky është viti i parë që firma juaj do të auditojë këtë kompani, juve ju nevojitet të përftoni njohuri për biznesin dhe rreziqet e biznesit më të cilat ballafaqohet kjo kompani. Shënimet nga takimi juaj janë paraqitur më poshtë:

FreeSO shet veshmbathje, me strategji të shes artikuj të modës së lart sipas emrit të brendit FSO. Çdo tetë javë futen veshje të reja në dyqane. Kompania mbështetet në një ekip të dizajnerëve me aftësi të lart për të zhvilluar veshje të reja mode. Dizajnerët duhet të jenë në gjendje të parashikojnë ndryshimet në preferenca të konsumatorëve dhe të reagojnë shpejtë. Ka një qarkullim të lart të personelit në ekipin e dizajnit.

Shumica e shitjeve bëhet në dyqane, por gjithashtu ka një katalog të popullarizuar nga i cili konsumatorët porosisin përmes faqes së internetit ose përmes telefonit. Kompania së voni ka përmirësuar sistemin e saj të kompjuterizuar dhe faqen e internetit me një kosto domethënëse me qëllim të integritimit të shitjeve online direkt në librin kryesor dhe për të ofruar një qasje më të lehtë për konsumatorët kur porosisin online dhe kur i japin detajet e kredit kartelave të tyre. Sistemi i ri online ka lejuar për herë të parë edhe shitjet jashtë vendit.

Sistemi për porosi përmes telefonit është kontraktuar nga jashtë. Kontraktori e ka fituar këtë punë përmes tenderimit dhe FreeSO i ka dhënë kontratën kësaj kompanie për shkak të çmimit më të ulët. Kompania që ofron këtë shërbim përdor qendrat e thirrjeve (call center) jashtë shtetit ku kosto e stafit është shumë e ulët.

FreeSO tash së voni i është bashkangjitur Iniciativës së Tregtisë Etike. Kjo është një iniciativë e 'tregtisë fer' që do të thotë se secili produkt që mban emrin e brendit FSO është dashur të prodhohet në mënyrë që është e pastër dhe e sigurt për punonjësit të prodhimit dhe minimizon ndikimin mjedisor të procesit të prodhimit. Është ndërmarrë një fushatë domethënëse reklamuese nga FreeSO për këtë iniciativë. Brendi FSO është blerë para disa viteve dhe është njohur sipas koston si pasuri e patrupëzuar, e cila nuk amortizohet. Brendi përfaqëson 12% të pasurive totale në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kompania ka në pronësi një numër të qendrave të shpërndarjes, disa nga të cilat operojnë në zona të ndryshme rezidenciale. Për secilën qendër të shpërndarjes kuvendet komunale lëshojnë licencë të operimit dhe njëra nga kushtet për licencë është se dërgesat duhet të ndodhin në mes të orës 08:00 deri në 18:00. Autoritetet po ashtu monitorojnë nivelet e zhurmës të secilës qendër dhe mund ta tërheqin licencën nëse tejkalohe limitet e caktuar të zhurmës. Dy licencat janë tërhequr për një periudhë tremujore gjatë këtij viti.

Për të ju ndihmuar në përfundimin e njohurisë së biznesit, Zeni ju ka dërguar me email ekstraktet nga draft pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe shifrat krahasuese përkatëse të praqitura më poshtë.

Ekstrakt nga draft pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse:

Viti që përfundon me 31 dhjetor	2016 Draft (në miliona €)	2016 Aktual (në miliona €)
Të hyrat		
Nga dyqanet	1,030	1,140
Nga shitjet online dhe përmes telefonit	425	395
Gjithsej të hyra	1,455	1,535
Fitimi operativ	245	275
Kosto financiare	(25)	(22)
Fitimi para tatimit	220	253

Viti që përfundon me 31 dhjetor	2016 Draft	2016 Aktual
Informata shitesë		
Numri i dyqaneve	210	208
Të hyrat mesatare për dyqan	€4.905 million	€5.77 million
Numri i porosive përmes telefonit	680,000	790,000
Numri i porosive online	1,020,000	526,667
Të hyrat mesatare për porosi online	€250	€300

**Kërkohet:**

(a) Përgatitni një memo që do të përdoret në takimin e planifikimit të auditimit me ekipin tuaj të auditimit, në të cilën memo vlerësoni rreziqet e biznesit me të cilat ballafaqohet FreeSO dhe të cilat duhet të konsiderohen kur planifikohet auditimi përfundimtar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. (15 pikë)

(b) Duke përdorur informatat e ofruara, identifikoni dhe shpjegoni PESË rreziqe të pasqyrave financiare. (10 pikë)

**(25 pikë)**

## Zgjidhja

### Hyrje

Kjo memo vlerëson rreziqet biznesor me të cilat ballafaqohet klienti i cili operon në industrinë me pakicë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016.

### Aftësia për të prodhuar artikuj mode

Kompania mbështetet në staf me aftësi të prodhoj artikuj të veshjeve të modës së lart si dhe me aftësi për të reaguar shpejtë në rast të ndryshimit të tregut. Nëse kompania dështon të tërheq dhe mbaj staf të kualifikuar me këto aftësi, produktet e kompanisë nuk mund të jenë tërëheqës për konsumatorët. Kjo tregohet edhe përmes qarkullimit të lart në staf e cila mund të ndikojë në zvogëlimin e shitjeve. Gjithashtu mund të ketë kosto të lart të rekrutimit të personave me aftësi të tilla.

### Marzhat e stoqeve dhe dalja nga moda e tyre

Ka një rrezik të lart operacional se linjat e prodhimit do të dalin nga moda shpejtë, sepse produkte të reja futen në treg çdo 8 javë që mund të rezultojë me sasi të mëdha të stoqeve jasht mode. Këto produkte mund të sjellen në vlerën e tyre të realizueshme me marzha më të ulëta. Nga rezultatet e paraqitura duket se marzha tashmë është ulur nga 17.9% në 2015 në 16.8% in 2016. Çfardo zbritje domethënëse e çmimeve të linjave të prodhimit do të shkaktojë rënie të metutjeshme të marzhës.

### Shtrirje e gjërë gjeografike e aktiviteteve të biznesit

Kompania operon me një numër të madh të dyqaneve, shumë qendra të shpërndarjes dhe ka funksione të kontraktuara jasht vendit. Ky lloj i modelit të biznesit mund të jetë i vështirë për tu kontrolluar, duke rritur kështu mundësinë e joefikasitetit, mangësive në sisteme dhe vjedhje të stoqeve dhe parasë.

### Tregtia aelektronike - vëllimi i shitjeve

Shitjeve online tani kanë vlerën prej €255 milion (€250 për porosi x 1,020,000 porosi). Në vitin e kaluar, shitjet online ishin €158 million (€300 per porosi x 526,667 porosi). Kjo përfaqëson një rritje prej 61.4% ( $255 - 158 / 158 \times 100\%$ ). Njëri nga rreziqet me shitjet online është shkalla e rritjes në vëllimin e transaksioneve, sidomos në kombinim me sistemin e ri të implementuar. Ka rrezik që sistemi mund të mos arrijë të procesojë vëllimin kaq të madh të transaksioneve, që mund të rezultojë me posori të papërmbyshura dhe konsumatorë të pakënaqur. Kjo mund të dëmtojë reputacionin e kompanisë dhe brendin e saj.

Kompania ka përmirësuar sistemin e kompjuterizuar për të integruar shitjet me librin kryesor. do të duhej të vendosej një plan i parandalimit të katastrofës në rast se sistemi ndalet ose ka problem. Nëse një plan i tillë nuk është vendosur atëherë ka rrezik se për shkak të dështimit të sistemit kompania mund të ketë humbje të të hyrave.

### Tregtia elektronike - siguria e sistemeve

Është e rëndësishme që sistemi i shitjes online të jetë i sigurt pasi që konsumatorët i japin detajet e kred kartelave gjatë blerjes. Çfardo shkelje e sigurisë mund të rezultojë me vjedhjen e të dhënave të ndjeshme të konsumatorëve dhe në këtë mënyrë kompania mund të jetë e obliguar për humbjet e shkaktuara të konsumatorëve. Në këtë rast mund të ketë probleme me reputacionin. Përveç kësaj, sistemi duhet të jetë i sigurt nga sulmet e virusëve që mund të shkaktojë dështim të sistemit, ndërprerje të shitjeve, konsumatorë të pakënaqur.

### Tregtia elektronike - çështjet rregullatore dhe tatimore

Ka disa rreziqe me pajtueshmërinë për shkak të shitjeve online. Shitjet jasht vendit e skpozojnë kompaninë ndaj komplikimeve me tatimin në shitje, siç mund të jenë taksat shtesë për eskport si dhe dokumentim shtesë që mund të nevojiten për të qenë në pajtueshmëri me rregulloret atje. Një çështje tjetër rregullative e rëndësishme është mbrojtja e të dhënave. Kompania ballafaqohet me rreziku e mospajtueshmërisë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave të konsumatorëve që ofrojnë ato detaje gjatë blerjes online.

Kompania tani shet edhe jasht vendit. Nëse shitjet bëhen në valuta të ndryshme, binzesa mund ti ekspozohet rrezikut të luhajtjes së normave të këmbimit valuator të cilat mund të ndikojnë direkt mbi marzhat e fitimit.

### Kontraktimi i sistemit të posorisë përmes telefonit

Fakti që kompania është përfshirë në kontraktimin e shërbimeve me çmimin më të ulët mund të çojë në rrezik të biznesit. Stafit i qendrës së thirrjeve mund të mos jetë i motivuar si duhet për shkak të pagave të ulëta që mund të çojë në pakënaqësi të konsumatorëve. Pasi që qendra e thirrjeve është jashtë vendit, stafit mund të ketë një gjuhë amtare të ndryshme nga kompania që mund të rezultojë me pakënaqësi të konsumatorëve nëse ata nuk mund të kuptohen lehtë. Përveç kësaj, mund të ketë mungesa të stafit për shkak të pagave të ulëta që mund të çojë në shitje të humbura.

Qendrat e thirrjeve jashtë vendit nuk janë gjithmonë të popullarizuara për konsumatorët. Mirepo kompania ka edhe sistemin e shitjeve online që është një zëvendësim i thirrjeve telefonike. Një fakt tjetër është se për shkak të çmimit të ulët, kontraktori mund të ndërprej kontratën para kohe për shkak të pamundësisë së mbulimit të kostove.

#### **Iniciativa e tregimit etik**

Kompania ka vendosur të bashkëngjitet iniciativës që mbështet mirëqenien sociale dhe mjedisore për të promovuar përgjegjësinë korporative sociale. Rreziku i shoqëruar me këtë është se nëse produktet nuk prodhohen sipas këtyre parimeve dhe nuk monitorohen mund të etë efekt të kundërt, konsumatorë të pakënaqur.

#### **Qendrat e shpërndarjes**

Ka rrezik të mospajtueshmërisë me licencat operative nga kuvendet komunale. Autoritetet monitorojnë nivelin e zhurmës dhe nëse kompania nuk është në pajtueshmëri me këto rregulla mund të humbin licencën që mund të shkaktojë problem të mëdha operationale me kompaninë. Gjithashtu mund të imponohen gjoha dhe ndëshkime nga autoritetet.

#### **Performanca financiare**

Të hyrat gjithsej kanë rënë për €80 milion, ose 5.2% ( $80/1,535 \times 100$ ). Fitimi operativ ka rënë për by €30 million, ose 10.9% ( $30/275 \times 100$ ). Informata gjithashtu tregon se mesatarja e të hyrave për porosi ka rënë nga €300 në €250. Këto fakte mund të shkaktojnë shqetësime, por shpenzimet e vitit 2016 mund të përmbajnë shpenzime të njehershme siç janë kotot e sistemeve të reja online dhe reklamat për iniciativën e 'tregtisë fer'. Rënia e të hyrave për porosi mund të jetë simptomë e vështirësive të përgjithshme ekonomike. Kompania ka rritur vëllimin e transaksioneve online prandaj si rezultat rënia e përgjithshme e marzhës nuk ka mundësi të rritë rrezikun.

Kosto financiare e kompanisë është rritur për €3 milion, që kontribuon në rënien e fitimit para tatimit me 13%. Kompania ka mbulim të mjaftueshëm të interesit që do të thotë se kjo nuk është një shqetësim i menjëhershëm por kompania duhet të sigurojë të mos teprohen kostot financiare.

### **(b) Rreziqet e pasqyrave financiare**

#### **Vlerësimi i stoqeve**

Linjat e produkteve të modës së lart kanë mundësi të dalin jashtë mode shumë shpejtë. Kompania tenton të ketë linja të reja në dyqane çdo tetë javë prandaj linjat e prodhimit kanë jetë të shkurtër në dyqane. Siaps SNK 2, stoqet duhet të vlerësohen sipas kostos ose VNR cilda që është më e ultë, prandaj këto stoqe mund të jenë të mbivlerësuar në fund të vitit nëse nuk monitorohen si duhet. Rënia e shitjeve mund të jetë tregues se brendi i kompanisë është më pak në hap me modën që çon në një rrezik të lart të stoqeve të dala jashtë përdorimit.

Porositë e bëra përmes telefonit ose përmes internetit janë më të ndjeshme ndaj kthimit të mallrave të blera, pasi që konsumatorët mund të zbulojnë më vonë se madhësia nuk është e përshtatshme ose nuk i pëlqen artikulli i blerë. Ka rrezik se nuk është njohur provision i mjaftueshëm në pasqyrat financiare për mallrat e kthyer.

#### **Plotësia/ekzistenca e stoqeve**

Kompania ka 210 dyqane dhe një numër të qendrave të shpërndarjes. Mund të jetë e vështirë të sigurohet se numërimi i stoqeve është i saktë në këtë situatë. Mund të ketë sasi të mëdha të stoqeve në transit në fund të vitit të cilat nuk do të merren parasysh gjatë numërimit duke rezultuar me sasi të pasakta të stoqeve. Gjithashtu mund të jetë e vështirë për auditorin të verifikojë ekzistencën e stoqeve nëse nuk mund të verifikohet fizikisht. Stoqet mund të jenë subject i raportimit mashtrues financiar, sepse mund të jetë e lehtë për menaxhmentit të fryjë

sasitë e stoqeve të njohura në pasqyrën e pozitës financiare. Stoqet mund të jenë po ashtu subject i vjedhjes.

#### **Të hyrat e paregjistruara**

Sistemet e shitjes online dhe përmes telefonit mund të kontribuojnë në rrezikun e anomalisë në të hyra. E para, sistemi i shitjes online është i integruar me librin kryesor, prandaj shitjet e bëra përmes këtij sistemi duhet që automatikisht të postohen në libra. Mirepo, sistemi është i ri dhe është e mundur që integrimi të mos funksionojë si duhet.

#### **Mbikapitalizimi i kostove të TI/faques së internetit**

Sistemi i shitjeve online është përmirësuar me një kosto domethënëse. Ka rrezik se kostot janë kapitalizuar në mënyrë të pasaktë. SIC 32 *Pasuritë e patrupëzuara – kosto të faques së internetit* thekson se vetëm kosto që lidhen me fazën e zhvillimit duhet të kapitalizohen, por kosto e planifikimit dhe të gjitha kostot tjera pasi që faqja është operacionale duhet të shpenzohen. Kosto e zhvillimit të softuerit ndjek parimet e njëjta. Prandaj ka rrezik të mbivlerësimit të pasurive dhe shpenzime të panjohura.

#### **Mbivlerësimi i brendit**

Emri i brendit është njohur si një pasuri e patrupëzuar që është trajtim i saktë kontabël për brendet e blera.

Pasuritë mund të jenë të mbivlerësuara për shka të dy arsyeve. E para, nëse nuk ngarkohet amortizim, menaxhmenti supozon se nuk ka fund periudha brenda së cilës brendi gjeneron të përfitime ekonomike. Kjo mund të jetë optimiste dhe ka rrezik se brendi është i mbivlerësuar dhe shpenzimet operative nuk janë të plota për shkak se nuk ka shpenzim të amortizimit. Një pasuri e patrupëzuar e cila nuk amortizohet duhet ti nënshtrohet testimit vjetor për dëmtim në pajtueshmëri me SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara*.

Nëse nuk bëhet një rishikim i tillë, pasuria mund të jetë e mbivlerësuar. E dyta, është bërë një shpenzim i madh për reklamimin e emrit të brendit gjatë vitit. Kjo shumë duhet të shpenzohet dhe jo të kapitalizohet.

#### **Mbivlerësimi i pronave**

Ka dy tregues nga skenari se pronat duhet të testohen për dëmtim prandaj mund të jenë të mbivlerësuara.

E para është mundësia e një qendre të humb licencën. Nëse ndodhë kjo, pasuri ndërprehen ofrimin e përfitimit ekonomik dhe kjo çon në rishikimin e dëmtimit për atë pasuri. E dyta, mesatarja e të hyrave për dyqan ka rënë.

SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* sugjeron se performance ekonomike më e dobët se ajo e pritura është idikator për një asset të dëmtohet. Për këto arsye të dy këto dyqane mund të jenë të mbivlerësuara.

#### **Provizionet e panjohura/kontingjencat e pashpalosura**

Revokimi i licencës për operim mund të çoj në gjoba që duhet të paguhen ndaj autoriteteve. Dy licenca janë revokuar gjatë vitit. Ka rrezik që kompania nuk ka njohur si detyrim dhe nuk ka shpalosur këto në pasqyrat financiare në pajtueshmëri me SNK 37.

#### **Saldot fillestare dhe të dhënat krahasuese**

Pasi që ky është auditimi i parë i kompanisë, duhet të ketë kujdes të shtuar lidhur me saldot fillestare dhe të dhënat krahasuese pasi që nuk janë audituar nga firma jonë.

## Detyra 2

Ju jeni meanxher i auditimit për tre klient të firmës së auditimit Aruba. Viti fiskal për secilin nga klientët është 30 shtator 2016. Jeni duke rishikuar raportet e propozuara nga seniori i auditimit për dy klientët Alfa SHA dhe Beta SHA.

Alfa SHA është kompani e listuar dhe ka mbyllur në mënyrë të përhershme disa nga fabrikat e saj në maj të vitit 2016 me kosto të mbylljes të finalizuar dhe të paguar në tërësi në gusht të vitit 2016. Të gjitha fabrikat kanë prodhuar artikullin e njëjtë i cili ka kontribuar me 10% në të hyrat totale të Alfa për vitin që përfundon me 30 shtator 2016 (2015=23%). Mbyllja është diskutuar dhe shpalosur saktë dhe në tërësi në deklaratën e kryesuesit të bordit të kompanisë në raportin vjetor. Mirëpo mbyllja nuk është përmendur në shënimet e pasqyrave financiare dhe as nuk është shpalosur ndaras në pasqyrat financiare.

Seniori i auditimit ka propozuar opinion të pamodifikuar të auditimit për Alfa SHA pasi që çështja është adresuar në tërësi në deklaratën e kryesuesit të bordit në raportin vjetor të kompanisë.

Në tetor 2016 është dorëzuar pretendimi kundër Beta SHA, një shitës me pakicë i lodrave. Pretendimi është nga një konsumator i cili kishte rrëshqitur në shkallët me yndyrë para një dyqani të kompanisë. Çështja është shpalosur në tërësi në shënimet e pasqyrave financiare si një detyrim kontingjent material dhe letrat e punës së auditimit ofrojnë dëshmi të mjaftueshme se nuk ka nevojë të njihet ndonjë provizion pasi që avokatët e Beta SHA kanë deklaruar me shkrim se gjasa e suksesit të këtij pretendimi ka mundësi të vogël të realizimit.

Shuma e pretendimit është fikse dhe mund të mbulohet në mënyrë të mjaftueshme nga paraja e kompanisë.

Seniori i auditimit ka propozuar se opinionin e auditimit nuk duhet të rezervohet (kualifikohet) por duhet të përfshihet një paragraf i theksimit të çështjes pas opinionit të auditimit për të shpejguar situatën.

Gama SHA është themeluar në tetor të vitit 2015 duke përdorur një kredi bankare për tu financuar. Të hyrat për vitin e parë të tregtimit janë €750,000, dhe ka shpresa për rritje të madhe në vitet e ardhshme. Kompania shet me pakicë lodra të shtrenjta nga druri në një dyqan të vetëm. Dy drejtorët (të cilët po ashtu janë pronar të aksioneve të kompanisë) janë në dijeni që për shkak të madhësisë së vogël të kompanisë, pasqyrat financiare nuk duhet t'i nënshtrohen auditimit por nuk janë të sigurt nëse do të ketë ndonjë dobi nga auditimi vullnetar i pasqyrave financiare të vitit të parë. Drejtorët gjithashtu janë të vetdijshëm që mund të kryhet rishikim i pasqyrave financiare si alternativë e auditimit të plotë.

Gama SHA aktualisht punëson një kontabilist i cili ende nuk është kualifikuar i cili përgatit pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave në fund të vitit dhe i cili përgatit një përmbledhje të pasqyrave menaxheriale çdo tre muaj.

### Kërkohet:

(a) Vlerësoni nëse është i përshtatshëm raporti i auditimit i propozuar nga seniori i auditimit dhe në rastet kur nuk pajtoheni me raportin e propozuar rekomandoni ndryshimet në raport për:

(i) Alfa SHA; (6 pikë)

(ii) Beta SHA. (4 pikë) (nuk është i nevojshëm draftimi i raportit)

(b) Përshkruani përfitimet e mundshme për Gama SHA nëse zgjedh të auditoj pasqyrat financiare. (4 pikë)

(c) Duke iu referuar Gama SHA, diskutoni objektivat e angazhimit të rishikimit dhe krahasoni nivelin e sigurisë që ofrohet nga rishikimi kundrejt auditimit të pasqyrave financiare. (6 pikë)

**(20 pikë)**

## Zgjidhja

### (a) (i) Alfa

Mbyllja e fabrikës duhet të trajtohet sipas SNRF 5 *Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje nga operacionet e ndërprera*, për shkak të ndërprerjes së operacioneve të një komponente të madhe të biznesit. Është componente e madhe për shkak se kontribuon me 10% të të hyrave në 2016 dhe 23 në 2015. Është component e ndarë sepse fabrikat kaën prodhuar vetëm një artikull, që tregon se janë njësi e veçantë e gjenrimit të të hyrave.

Sipas SNRF 5 duhet të ketë shpalosje të veçantë në pasqyrën e të ardhurave në rezlutatet pas tatimore për të paraqitur fitimin ose humbjen nga operacionet e ndërprera. Të hyrat dhe kosto e operacioneve të ndërprera duhet të shpalose ose në faqene parë të pasqyrës së tëardhurave ose në shënimet e PF. Rrjedha e parasë lidhur me këto operacione duhet të shpaloset po ashtu ndaras ne pasqyrën e rrjedhës së parasë në pajtueshmëri me SNK 7.

Përveç kësaj, Alfa është kompani e listuar, SNKR 8 segmentete operative, kërkon që të bëhet raportim për segmentet për operacionet e ndërprera.

Dështimi për të shpalosur informatat e mësipërme në PF është materiale dhe shkelje e SNK-ve. Opinioni i auditorit duhet të ishte rezervuar mbi këtë fakt për shkak të mosmarrëveshjes. Çështjs është materiale por nuk është përhapëse prandaj opinion me 'përveç për' është i mjaftueshëm. TParagrafi i opinionit duhet qartë të theksoj arsyen e mosmarrëveshjes dhe të paraqitet ne PF. Opinioni i auditorit ka të bëjë vetëm me pasqyrat financiare dhe jo edhe me dekalrata tjera që përfshihen en raportin vjetor prandaj nuk është relevante nëse drejtorët e kanë shpalosur atë në seksione tjera të raportit vjetor.

### (ii) Beta

Pretendimi është një ngjarje pas datës së raportimit nëse aksidenti ka ndodhur para fundit të vitit, pretendimi ofron evidencë shtesë për gjendjen në fund të vitit prandaj edhe përmbushë definicionin e ngjarjes që kërkon korrigjim të pasqyrave. Në këtë rast çështja duhet të shpalosej në pasqyrat financiare në pajtueshmëri me SNK 10 ngjarjet pas datës së raportimit dhe SNK 37 Provizionet,..... Një provizon do të duhej të njihej vetëm nëse është e mundshme që pretendimi të jetë i suksesshëm, por në këtë rast nuk është ashtu. Prandaj nuk ka mosmarrëveshje, dhe nuk ka as kufizim të fushëveprimit.

Prandaj seniori ka të drejtë të propozoj opinion pazezervë.

Mirëpo, nuk është e domosdoshme që raporti i auditimit të përmbajë një paragraf të theksimit të çështjes..

SNK 701 Modifikimet në raportine auditorit thekson që paragrafi i theksimit të çështjet duhet të thekson një çështje që ka pasiguri materiale.

Siguritë materiale zakonisht konsiderohen të rëndësishme nëse përfshijnë një nivel të shqetësimit për hipotezën e vijimësisë. Ky nuk është rast i tillë pasi që kompani ka para të mjaftueshme ta mbulojë pretendimin.

### (b) Ka disa përfitime për kompaninë të zgjedh auditimin në mënyre vullnetare.

Auditimi vjetor siguron se janë zbuluar gabimet/anomalitë ne pasqyrat financiare e përgatitura nga një kontabilist i pakualifikuar. Kjo është e rëndësishme për drejtorët që përdorin PF e fudnvitit për të analizuar progresin e vitti të parë në tregti dhe ju nevojiten të dhëna të besueshme për të vlerësuar performancën. Auitimi do ti sigurojë drejtorët se PF janë të paraqitura mire dhe mund ti përdorin për vendime biznesore.

Shifrat e sakta të vitit të para mundësojnë buxhetim më të mirë, parashikim të prasë që është shumë e rëndësishme për një rritje të biznesit. Auditorët kanë mundësi të përdorin raportet tremujore menaxheriale si pjese e auditimit normal. Auditorët mund të këshillojnë kontabilistin për përmirësimet që mund të bëhen në të ardhmen lidhur me këto raporte tremujore, për të rritur nivelin e hollëseive të përfshira.



Si një produkt anësor i auditimit është edhe letra e menaxhmentit. Kjo letër do të identifikoj dobësitë dhe do të rekomandojë përmirësimet në fushat siç është sistemi i kontrollit të brendshëm. Ka mundësi që kompania të ketë nevojë për financim shtesë nga bankat, prandaj raporti i auditorit do të ju ndihmojë kredidhënësve të vlerësojnë kompaninë më lehtë që mund të ndikojë në kosto më të ulët të financimit

Pasi që biznesi operon me shitje me para dhe shet artikuj të vegjël me vlerë të madhe, ka rrezik të vjedhjes së pasurisë. Auditimi i jashtëm mund të ketë rol të dyfishtë, parandalues dhe zbulues i anomalive duke zvogëluar kështu rrezikun e mashtrimit.

Pasqyrat financiare të sakta do të jenë baza më e mirë për vlerësimin tatimor dhe planifikimin tatimor. Raporti i auditimit e rrit kredibilitetin e shifrave.

Zgjedhja që kompania vendos të auditohet nga viti i para e zvogëlon rrezikun që gabimet e mundshme të barten në vitet e ardhshme.

**(c) Qëllimi i angazhimeve për rishikim është të mundësoj auditorin të përftojë siguri mesatare nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me kornizën e pranueshme të raportimit financiar.**

Për të përtuar këtë siguri, është e domosdoshme të grumbullohen evidence duke përdorur procedura analitike dhe përmes pyetjeve të menaxhmentit. Procedurat e detajuara të pavarura nuk do të kryhen përveç nëse auditori ka arsye të besoj se informata mund të përmbajnë anomali materiale.

Auditori duhet të qaset angazhimit me nivel të lartë të skepticizmit profesional, duke kërkuar rrethana që mund të shkaktojnë anomali në PF.

Si rezultat i procedurave të kryera auditori do të jetë në gjendje të shprehet më shkrim lidhur me përfundimin e arritur.

Siguria negative do të thotë se auditori ka kryer procedura të kufizuara dhe ka arritur në përfundim se pasqyrat financiare duhet të aryeshme. Përdoruesit e PF përftojnë një rehati se shifrat financiare u janë nënshtruar rishikimit financiar.

Në krahasim me auditimin, siguri e nivelit të lartë, auditorët ofrojnë një opinion pozitiv por nuk ofrojnë siguri absolute. Përdoruesi sigurohet se shifrat janë të pastra nga anomalitë materiale dhe se auditori ka mbështetur opinionin mbi procedurat e kryera.

### Detyra 3

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Nailja & Partnerët. Ju jeni duke i rishikuar tri situata të cilat janë diskutuar në takimin mujor të menaxherëve të auditimit në firmë tuaj:

(1) Nailja & Partnerët është kontaktuar nga një klient i mundshëm i auditimit, Balaj SHA. Firma juaj është e interesuar të marr këtë angazhim dhe aktualisht është duke i kryer procedurat e pranimit të klientit. Balaj SHA është themeluar para një kohe të shkurtër nga Yllëzon Balaj si aksionar i vetëm dhe aktiviteti kryesor i kompanisë është shitja me pakicë e arkave të drurit.

(2) Nailja & Partnerët i ofron shërbime të auditimit kompanisë Fina SHA, një organizatë vendore e shërbimeve financiare. Për shkak të një numri të madh të gabimeve në regjistrimin e depozitave me para të gatshme nga një konsumator i ri që janë zbuluar nga auditimi i brendshëm, drejtorët e Fina SHA kanë kërkuar një rishikim të sistemeve të kompjuterizuara të informatave financiare. Jeni njoftuar se gjatë punës në planifikim të Fina SHA, Artani njëri nga asistentët tuaj të auditimit i cili sapo ka diplomuar në drejtimin e teknologjisë informative i ka kaluar tre orë duke i këshilluar auditorët e brendshëm se si të përmirësohen këto sisteme. Aq sa dini, kjo këshillë nuk është përdorur nga auditorët e brendshëm të kompanisë.

(3) Langu SHA është prodhues i pijeve në shishe dhe është klient i Nailja & Partnerët që pesë vite. Dy nga asistentët e firmës tuaj kanë marr pjesë në numërimin e stoqeve të hënën e kaluar. Ata raportuan se Brikena, menaxherja e re e prodhimit në kompaninë Langu ka kërkuar të bëhet numërimi dhe kryerja e procedurave të auditimit sa më shpejtë që është e mundur. Si nxitje për këtë ajo u ka ofruar dhjetë shishe të 'Super Lëngu' nga fundi i linjës së prodhimit. Brikena po ashtu i ka ftuar asistentët e auditimit të bashkëngjiten në një festë në zyrat e kompanisë. Festa kishte filluar menjëherë pas përfundimit të numërimit të stoqeve. Numërimi i stoqeve dhe procedurat e auditimit kishin përfunduar brenda dy orësh (procedurat e njëjta vitin e kaluar kishin zgjatur një ditë të plotë) dhe asistentët pastaj kishin kaluar katër orë në festë.

#### **Kërkohet:**

(a) Përkufizoni 'pastrimin e parasë' dhe përshkruani procedurat që janë specifike për pastrimin e parasë që duhet të konsiderohen para dhe gjatë pranimit të angazhimit për auditim të Balaj SHA.

(5 pikë)

(b) Duke u referuar Fina SHA, shpjegoni çështjet etike dhe çështjet tjera profesionale. (9 pikë)

(c) Identifikoni dhe diskutoni çështjet etike dhe profesionale lidhur me numërimin e stoqeve të Langu SHA.

(6 pikë)

**(20 pikë)**

## Zgjidhja

**(a)** – Pastrimi i parasë është proces përmes të cilit kriminelët tentojnë të fshehin origjinën e vërtetë dhe pronësinë e parave të gjeneruara nga aktivitetet kriminale, duke i lejuar atyre të mbajnë kontrollin mbi ato para dhe në fund të ofrojnë një mbulësë legjitime për burimin e të hyrave. Qëllimi i pastrimit të parasë është thyhet lidhja në mes të parasë dhe krimit nga i cili ka rezultuar.

Procedurat përfshijnë:

- Identifikimi i klientit

➤ Përcaktimi i identitetit dhe aktivitetit të biznesit, psh duke përfutur pasaportën, adresën, certifikatën e biznesit.

➤ Konsiderimi nëse aktiviteti komercial ka kuptim biznesor (pra nuk është vetëm 'fytyra' e një aktiviteti joligjor)

➤ Përcaktimi i listës së aksionarëve kryesor dhe drejtorëve.

- Njohja me klientin:

➤ Komunikimi para angazhimit për të shpjeguar pronarit dhe drejtorëve të tjerë për natyrë dhe arsyet e procedurave të pranimit të angazhimit.

➤ Praktikën më të mira rekomandojnë se letra e angazhimit duhet të përfshijë paragraf në të cilët përshkruhet përgjegjësia e auditorit lidhur me pastrimin e parasë.

**(b)** Ka disa çështje që duhet të adresohen:

Duhet të planifikohet punë shtesë për të zbuluar shtrirjen e problemeve me kontrollet e brendshme që kanë ndodhur gjatë vitit. Është e rëndësishme të përcaktohet nëse gabimet janë të izoluara ose kanë vazhduar gjatë tërë periudhës.

Duhet të bëhet rishikimi i letrave të punëve auditorit të brendshëm.

Duhet të përcaktohet materialiteti i gabimeve.

Gabimet e zbuluara në sistemin e kontabilitetit do të ketë efekt serioz në qasjen e planifikimit të auditimit dhe për depozitat e konsumatorin e ri. Firma e auditimit duhet të planifikojë të zgjerojë testet e auditimit pasi rreziku i auditimit në këtë fushë është i lartë. Më shumë teste thelbësore dhe më pak mbështetje në kontrolle të brendshme.

Për shkak të kombinimit të këtyre fakteve ka gjasë që auditimi të zgjasë më shumë. Kjo mund të ketë implikime me koston e auditimit dhe me afatin e përfundimit të auditimit, një fakt që duhet të diskutohet me kompaninë.

Për shkak të rrezikut të rritur të auditimit, firma e auditimit duhet të konsiderojë zgjerimin e procedurave të rishikimit përgjatë tërë auditimit. Përveç kësaj, kompania ka gjasë të jetë në industri që është e rregulluar shumë, që rrit edhe vëmendjen në opinionin e auditimit. Këta faktorë trgojnë kërkesën për rishikim të domosdoshëm nga partneri i dytë.

Çështje e veçantë është këshillimi i klientit nga juniori auditimit. E para, asistentët e auditimit duhet t'i nënshtrohen rishikimit dhe drejtimin të afërt nga mbikqyrësit dhe këtu duket se nuk ka mbikqyrje të duhur.

E dyta, asistenti nuk është dashur të ofroj këshilla për auditimet e brendshëm. Ai është dashur të lajmëronte seniorin i cili do të duhej të vendoste për qasjen e duhur. Kjo tregon se asistenti nuk ka njohuri dhe nuk e kupton përgjegjësinë që ka ndaj klientëve të auditimit dhe ndaj firmës së auditimit. E treta, asistenti duhet të merret në pyetje për të përcaktuar se çka e ka këshilluar auditorin e brendshëm. Pa marr parasysh kaulifikimit akademik, ai ka pak përvojë praktike në sistemet informative financiare. Ai mund të ketë ofruar këshilla të papërshtatshme, prandaj është e rëndësishme të konfirmohet nëse auditorët nuk kanë marr ndonjë veprim si pasojë e këshillës. Në fund, firma e auditimit duhet të konsideroj nëse ata si firmë mund të ofrojnë rishikim të sistemit informative financiar. Kodi i Etikës i IFAC vendos kufizimelidhur me shërbimet joaudituese dhe firma duhet të qartësoj se çka nënkuptohet me 'rishikim'.

Nëse ofrohet një përmbledhje e dobësive në sistem me rekomandime të nevojshme, atëherë kjo konsiderohet pjesë e procedurave normale të auditimit. Mirëpo, duke konsideruar gabimet që janë paraqitur gjatë vitit, kompania mund të kërkojë nga firma e auditimit të implementojë ndryshime në sistem. Ky rast do të ishte kërcënim i vet-rishikimit dhe duhet të konsiderohet vetëm nëse vendosen masa mbrojtëse domethënëse, psh përdorimi i ekipeve të ndryshme dhe të ketë rishikim të punës nga partneri i dytë.

(c) Ka disa çështje etike lidhur me numërimin e stoqeve.

E para, nuk është e përshtatshme të ofrohen nxitje për juniorët e auditimit. Pasi që ajo është menaxhere e re, ajo mund të mos e dijë si perceptohen këto nxitje. Brikena duhet të ishte e informuar se veprimet e saj kanë pasoja serioze.

Oferta mund të perceptohet si mito për juniorët e auditimit dhe si kërcënim i interesit vetiak pasi që u është ofruar një përfitim financiar.

Duhet të përcaktohet vlera e dhjetë shisheve të lëngut, sepse për anëtarët e ekipit të auditimit do të ishte e përshtatshme të pranohet vetëm diçka që ka vlerë të parëndësishme. Në fund, do të jetë vendimi i partnerit të auditimit nëse vlera është e parëndësishme.

Gjithashtu, nëse juniorët i kanë pranuar shishet e lëngut, kjo mund të ndikojë në numërimin fizik të mallrave dhe prerjen e tyre. Prandaj juniorët është dashur të refuzojnë ofertën.

Puna e kryer nga juniorët lidhur me numërimin e stoqeve duhet të rishikohet. Procedurat e auditimit janë kryer shumë shpejtë prandaj duhet të kontrollohet nëse janë grumbulluar dëshimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

Po ashtu juniorët e auditimit nuk është dashur të marrin pjesë në festën e zyrës pa miratimin e menaxherit të auditimit.

Duket se festë aka ndodhur gjatë orarit të punës dhe juniorët është dashur të përfundojnë procedurat me stoqet. Si rrjedhojë juniorët nuk kanë vepruar me kujdes të duhur profesional dhe mund të konsiderohet si ju mungon integriteti.

Veprimet e juniorëve duhet të diskutohen dhe ka gjasa të ndërmerren masa disiplinore. Po ashtu ka pyetje nëse udhëheqja dhe mbikqyrja e juniorëve ka qenë e mjaftueshme. Pasi që juniorët janë të rinj, ka gjasë që ata ta kenë kryerë numërimin e stoqeve për herë të parë.

Është dashur që juniorët e auditimit të ishim mbikqyrur dhe shoqeruar nga një senior ose menaxher i auditimit.

#### Detyra 4

Ju jeni menaxher në firmën e auditimit Mona e cila ka tre zyra dhe 12 partnerë. Rreth 1/3 e klientëve të firmës janë klient të auditimit, pjesa tjetër janë klient të cilëve firma ju ofron shërbime të tatimeve, kontabilitetit dhe konsulencë biznesore.

Firma është duke konsideruar si të gjenerojë më shumë të hyra dhe nga ju është kërkuar të vlerësoni dy propozime të bëra nga menaxheri i zhvillimit të biznesit.

(i) Mund të vendoset një reklamë në gazetata ditore për të tërhequr klient të rinj. Drafti i reklamës është dhënë për tu rishikuar nga ju:

Mona është firma më e madhe dhe ofruesja më profesionale e shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit. Ne ofrojmë një gamë të shërbimeve përveç auditimit, të cilat garantojnë të përmirësojnë efikasitetin e biznesit tuaj dhe ju kursejnë tatimet.

Nëse jeni të pakënaqur me auditorët tanë, ne mund të ofrojmë një opinion të dytë mbi raportin të cilin ju kanë ofruar.

Ofertë: për të gjithë klientët e rinj, ofrojmë 25% zbritje në rast se ju ofrohet auditimi dhe shërbimet e tatimeve. Tarifat tona janë të aprovuara nga ShKÇAK.

(8 pikë)

(ii) Një partner i ri me përvojë në sektorin bankar i është bashkangjitur firmës Mona. Është sugjeruar që partneri mund të specializohet në ofrimin e shërbimit të financave të korporatave për klientët. Në veçanti, partneri mund të këshillojë klientët si të përfitojnë financim përmes borxhit dhe mund të negocionte me bankat ose ofruesve tjerë të financimit në emër të klientëve. Tarifa që do të ngarkohej për këtë shërbim do të ishte tarifë kontingente që lidhet me marrjen e kredisë me një kosto të huamarrjes nën normën e tregut.

(5 pikë)

#### Kërkohet:

Vlerësoni secilin nga sugjerimet e bëra më sipër duke komentuar mbi çështjet etike dhe profesionale.

*Shënim: alokimi i pikëve është treguar më sipër.*

(b) Ju keni themeluar një sistem të diktimit në të cilin debatohen çështjet aktuale nga të punësuarit dhe partnerët e Mona. Një postim në këtë sistem ka të bëjë me rrotacionin e obligueshëm të firmave të auditimit sipas të cilit ishte sugjeruar nga gazetarët që pas një periudhe të paracaktuar firma e auditimit duhet të jep dorëheqje nga klienti dhe të zëvendësohet nga një firmë tjetër e auditimit.

#### Kërkohet:

(i) Vlerësoni kërcënimet etike të krijuara nga shoqërimi i gjatë me klientët e auditimit. (3 pikë)

(ii) Vlerësoni përparësitë dhe pengesat e rrotacionit të obligueshëm të firmave të auditimit.

(4 pikë)

**(Toal 20 pikë)**

## Zgjidhja

**(a) (i)** Reklamimi nuk ndalohet nga Kodi i Etikës së IFAC. Mirëpo Kodi thekson se kontabilistët profesionist nuk duhet të dikreditojnë profesionin kur reklamojnë shërbime profesionale. Kontabilisti profesionist në praktikën publike duhet të jetë i ndershëm dhe i sigurtë kur bën reklama për shërbime dhe nuk duhet:

- Të bëjë pretendime të ekzagjeruara për shërbimet që ofron, kualifikimet që posedon ose përvojën që ka;

- Të jetë çorientuese as direkt as të perceptohet;

- Të bëjë referenca nënçmuese ose krahasime tëpabazuara me punën e tjetrit.

Përveç konsiderimit të çështjeve më sipër, firmat e auditimit/kontabilitetit duhet të sigurojnë se reklamat janë në pajtueshmeri me rregullat vendore.

Reklama e firmës fillon me pretendimin se firma është më e madhja në vend. Firma ka vetëm tre zyra dhe 12 partner, dhe do të ishte çorientuese të pretendohet se është më e madhja në vend. Po ashtu pretendohet se firma është 'më profesionalja'. Ky pretendim është vështë të provohet dhe mund të jetë çorientuese pasi që publiku mund ta perceptoj se ajo firmë është 'më e mirë' se firmat tjera.

Reklama pretendon se shërbimet e firmës garantojnë përmirësimin e efikasitetit të biznesit. Kjo nuk mund të garantohet, prandaj reklama nuk është e ndershme. Gjthashtu, firma garanton se do të kursej taksa për klientët. As kjo nuk mund të garantohet sepse secili klient individual ka çështje të ndryshme tatimore dhe vetëm përmes hetimit të detajuar mund të përcaktohet kursimi i tatimeve.

Gjithashtu, pretendimet rrisin rrezikun se firma mund të ekspozohet padive gjyqësore, pasi që nese klientët që angazhojnë firmën nuk shohin përmirësim të efikasitetit të biznesit ose ulje të tatimeve, mund ta padisin firmën në gjyq.

Opinionet e dyta nuk janë të ndaluara por është e pazakont për klientët të kërkojnë opinione të dyta dhe është ekstremisht e pazakont të reklamohet ky shërbim. Reklamimi nenkupton se firma mund të ofroj opinion'më të mirë' se firmat e tjera, që është tepër joprofesionale dhe pa integritet. Po ashtu reklama nënkutpon për publikun se është normale të kërkohet opinion i dytë.

Ofrimi i një tarife hyrëse nuk është e ndaluar. Mirëpo, tarifat duhet të llogariten bazuar në kohën që nevojitet për të kryer një angazhim për të siguruar se është ofruar shërbim me cilësi. Ofrimi i një zbritje prej 25% mund të rezultojë me punë me cilësi të dobët.

Po ashtu nuk është e mençur që firma të ofroj zbritje pasi që ofrohen dy shërbime e sidmos ato tek të cilat mund të lind kërcënimi i pavarësisë nga vetrishikimi dhe avokimi.

Reklama pretendon se tarifat e firmës janë të aprovuara nga ShKÇAK. Ky është pretendim i rrejtshëm pasi që ShKÇAK nuk monitoron e as nuk aprovon tarifa të shërbimeve, dhe në këtë rast është duke u shfrytëzuar brendi i 'SHKÇAK' që është shumë joprofesionale. Kjo mund të çoj në veprime disiplinore kundër partnerëve individual të firmës nga ShKÇAK.

**(ii)** Edhe pse partneri i ri ka përvojë në sektorin bankar, dhe duket se është kompetent të ofroj shërbime të Financave të korporatave, ka disa problem lidhur me këtë çështje. Problemi i parë është negociimi në emër të klientit. Firma e auditimit i ekspozohet kërcënimit të avokimit dhe vetrishikimit. Ky kërcënim ndodhë kur auditori merr pozicionin në emër të klientit dhe pomovon interesat e klientit ndaj palës së tretë. Firma e auditimit mund të perceptohet se ka marr rol menaxherial, prandaj kjo komprometon pavarësinë.

Madhësia e çfardo kërcënimi ndaj pavarësisë duhet të vlerësohet dhe të vendosen masa mbrojtëse për të zvogëluar kërcënimin në nivel të pranueshëm. Këto mund të përfshijnë:

- Sigurimi se partneri i ri nuk është i përfshirë në auditimin e klientit; ose

- Përdorimi i profesionistëve të cilët nuk janë përfshirë në ofrimin e shërbimeve të Financave të korporatave për të këshilluar ekipin e auditimit mbi shërbimet dhe të rishikojnë trajtimin kontabël.

Çështja e dytë është tarifa kontingjente. Një tarifë kontingjente është një tarifë që varet nga rezultati, në këtë rast rezultati është marrja e kredive me normë të favroshme interesin nën çmimin e tregut.

Tarifat kontingjente nuk janë të lejuara për angazhimet në auditimi sipas kodit të etikës. Për shërbimet joaudituese që kryhen për klientët e auditimit, tarifat kontingjente përsëri mund të krijojnë kërcënim të madh të interesit vetiak sa që asnjë masë mbrojtëse të mos mund ta zvogëlojë në nivel të pranueshëm. Është zakonisht e papërshtatshme të pranohet tarifë kontingjente për shërbimet jo-audituese për klientet e auditimit, përveç nëse tarifa është tepër e parëndësishme.

Mirëpo, tarifa kontingjente mund të përdoret për shërbimet e Financave të korporatave për klientët tjerë. Mund të paraqitet interesi vetial dhe firma duhet të vlerësojë rëndësinë këtij kërcënimi duket vlerësuar natyrën e angazhimit.

Nëse firma e auditimit vazhdon të ofroj këto shërbime për klient tjerë nga auditimi, duhet të konsiderohen disa masa mbrojtëse:

- Një marrëveshje me shkrim me klientin lidhur me bazën e kompenzimit
- Sigurimi se partneri që ofron shërbime të Financave të korporatave nuk është përfshirë në punë tjera me klientin e njëjtë.

**(b) (i)** Nuk është e pazakont që firmat të ofrojnë shërbime të auditimit klientëve për një periudhë më të gjatë. Mirëpo, Kodi i Etikës argumenton se përdorimi i personelit të njejtë senior për një periudhë të gjatë rritë kërcënimin e njohjes (familiaritetit) për pavarësinë ndaj klientit. Madhësia e kërcënimit varet nga:

- Periudha kohore;
- Roli i individit në ekipin e auditimit;
- Struktura e firmës;
- Natyra e angazhimit për siguri;
- A është ndryshuar menaxhmenti i klientit; dhe
- Nëse natyra, kompleksiteti dhe çështjet raportuese të klientit kanë ndryshuar.

Problemi i shoqërimit të gjatë është sse paraqitet kërcënimi i familjaritetit. Personeli senior rrezikon të humb skepticismin profesional dhe nuk sfidon çështjet domethënëse.

Kodi kërkon që për klientët me interes publik, partneri kyç i auditimit duhet të ndryshohet pas një periudhe të paracaktuar prej shtatë vitesh. Pas një periudhe të tillë partneri kyç nuk mund të kthehet në auditim të klient pa kaluar dy vite. Gjatë kësaj periudhë individit nuk duhet të ofroj kontroll të cilësisë për atë klient e as të konsultohet me ekipin e angazhimit.

**(ii)** Argumenti kryesor në favor të rrotacionit të obligueshëm të firmave të auditimit është me qëllim të eliminohet kërcënimi i familjaritetit. Jo vetëm rrotacioni i partnerëve kyç por të firmës në tërësi argumentohet se kjo e ruan kredibilitetin e raportit të auditorit dhe profesionin në tërësi.

Po ashtu mund të argumentohet se klientët mund të kenë dobi nga 'një palë sy të freskët' pas një numri të viteve.

Mirëpo, ka disa disavantazhe lidhur me rrotacionin e obligueshëm të firmave. E para, nga perspektiva e firmës së auditimit, do të ketë humbje të tarifave kur detyrohen të japin dorëheqje si auditor. Po ashtu, firma mund të mos jetë e gatshme të bëjë investime që do të rritë efikasitetin në një auditim të caktuar (psh investim në softuer) pasi që shpërblimi do të jetë afatshkurt. Efektiviteti i auditimit varet nga njohuria e akumuluar e firmës së auditimit dhe përvoja afatgjatë me aktivitetet e klientit dhe çështjet e raportimit financiar. Rrotacioni i obligueshëm e hedh poshtë këtë akumulim të njohurisë. Problemet e auditimit ka gjasë më të madhe të ndodhin kur firmës së auditimit i mungon kjo bazë. Në vitet e para auditorët do të kenë më pak njohuri për kompaninë e klientit dhe do të jenë në pozitë më të dobët të bëjnë gjykime.

Rrotacioni i obligueshëm rrit koston dhe krijon problem praktike. Me secilin rrotacion, duhet të sjellet një ekip i ri i auditimit dhe kjo paraqet problem me menaxhmentin e kompanisë. Sistemet

e kompanise duhet të vlerësohet dhe të dokumentohen. Rritja në kosto ka gjasa të bartet te klienti që do të rezultojë me tarifa më të larta të auditimit.

Nga perspektiva e klientit, si dhe duke u ballafaquar me tarifa të rritura dhe humbje të cilësisë së auditimit, rrotacioni periodic mund të jetë problematik për kompaninë.



## Detyra 5

Ju jeni partneri përgjegjës për rishikimin e kontrollit të cilësisë së angazhimit të auditimit të Super SHA. Aktualisht jeni duke rishikuar letrat e auditimit dhe draft raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare të Super SHA për vitin që përfundoi me 31 janar 2016. Draft pasqyrat financiare paraqesin të hyra prej €8.5 milion, fitim para tatimit prej €1 milion dhe pasuri totale prej €175 milion.

(a) Gjatë vitit fabrika e Super SHA ishte zgjeruar nga vetë-ndërtimi i një zone të re të procesimit me një kosto prej €5 milion. E përfshirë në kosto është kosto e kapitalizuar e huamarrjes prej €100,000, që ka ndodhur gjatë periudhës gjashtë mujore të ndërtimit. Një kredi prej €4 milion me një normë interesi prej 5% ishte marr nga banka lidhur me ndërtimin me 1 mars 2015, kur kishte filluar ndërtimi. Zona e re e procesimit ishte e gatshme për përdorim me 1 shtator 2015 dhe filloj të përdorej me 1 dhjetor 2015. Jeta e vlerësuar e përdorimit është 15 vite.

### **Kërkohet:**

Lidhur me rishikimin e dosjes së auditimit për pasuritë joqarkulluese:

Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen dhe evidencën që prisni të gjeni lidhur me zonën e re të procesimit. (8 pikë)

(b) Super SHA ka një plan të pensioneve me përfitime të definuara. Një vlerësim aktuarial me 31 janar 2016 ka treguar se plani është në deficit prej €10.5 milion. Deficiti nuk është njohur në pasqyrën e pozicionit financiar. Ekstrakti nga draft raporti i auditimit është paraqitur më poshtë:

#### *Opinionin i auditorit*

Në opinionin tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes së diskutuar më poshtë, pasqyrat financiare nuk paraqesin drejt pozitën financiare të kompanisë me 31 janar 2016 dhe të performancës financiare dhe rrejdhes së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### *Shpjegim për opinionin kundër lidhur me pensionet*

Pasqyrat financiare nuk përfshijnë planin pensional të kompanisë. Kjo shmangie e qëllimshme është në kundërshtim me praktikën e kontabilitetit dhe do të thotë se pasqyrat financiare nuk janë përgatitur si duhet.

### **Kërkohet:**

Vlerësoni në mënyrë kritike ekstraktin e propozuar të raportit të auditimit për Super SHA për vitin që përfundon me 31 janar 2016.

Shënim: nuk kërkohet të ridraftoni ekstraktin e raportit të auditimit. (7 pikë)

**(15 pikë)**

## Zgjidhja

### 5 (a) Çështjet që duhet të konsiderohen

Kosto totale e zonës së procesimit prej €5 milion përfaqëson 2.9% të pasurive totale dhe është materiale për pasqyrën e pozicionit financiar. Kosto e huamarrjes nuk është materiale për pasqyrën e pozicionit financiar, pasi që përfaqëson 1% të pasurive, mirëpo kjo kosto është materiale për fitimi pasi që është 10% të fitimit para tatimit.

Kostot që atribuohen direkt, përfshirë koston e huamarrjes që lidhen me zonën e re të procesimit duhet të kapitalizohen si pasuri joqarkulluese. Sipas SNK 23, kostot e huamarrjes që i atribuohen direkt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një pasurie që kualifikohet duhet të kapitalizohet si kosto e asetit. Kosto e huamarrjes duhet të kapitalizohet vetëm në periudhën e dënrimit, dhe të ndërpritet kapitalizimi kur të gjitha aktivitetet e përgatitjes për asetin kualifikues për përdorim ose shitje janë përfunduar.

Në këtë rast, zona e re e procesimit ishte e gatshme me 1 shtator, prandaj kapitalizimi i kostove duhet të ndërpritet në atë pikë. Duket se kosto e huamarrjes është kapitalizuar si duhet në vlerë prej €100,000, që paraqet gjashtë muaj interes të kredisë loan ( $€4m \times 5\% \times 6/12$ ).

Zona e re e procesimit duhet të zhvlerësohet nga 1 shtatori në pajtueshmeri me SNK 16.

Prandaj duhet të jenë të përfshira pesë muaj të zhvlerësimit në fitimin e vitit që përfundon me 31 janar 2016, në vlerë prej €138,889 ( $€5m/15 \text{ vite} \times 5/12$ ).

### Evidencat e auditimit

- Lista e komponentëve në vlerë prej €4.9 milion të kostove të kapitalizuara (duke €100,000 kosto të huamarrjes) të rishikohet për tu siguruar se të gjitha zërat janë të kapitalizueshme.
- Përputhja e një mostre të koston së kapitalizuar me dokumentet mbështetëse (psh faturat e cimentos, pagat, etj)
- Një kopje e buxhetit të aprovuar për shpenzimet kapitale
- Kopja e marrëveshjes për kredi për të konfirmuar shumën e kredisë, datën e pranimit të parasë, normën e interesit, etj.
- Dokumentet për të verifikuar se zona është përfunduar me 1 shtator, psh certifikata e pranimit teknik
- Rillogaritja e koston së huamarrjes, shpenzimi i zhvlerësimit, vlera bartëse dhe harmonizimi i këtyre shifrave me pasqyrat financiare.
- Konfirmimi i shtesave në pasuri joqarkulluese nëse janë shpalosur si duhet në PF.

**(b)** Titujt dhe pozicionimi i dy paragrafëve të përfshirë në ekstraktin e mësipërm nuk është i përshtatshëm. Sipas SNA 705, kur auditori modifikon opinionin, paragrafi duhet të vendoset para opinionit dhe të quhet 'Baza për opinion të kundërt', i cili përshkruar çështjen që ka rezultuar me modifikim. Ky paragraf pastaj ndiqet nga paragrafi i opinionit i cili duhet të titullohet 'opinion i kundërt'.

Në këtë rast, titujt janë të pasaktë dhe paragrafët duhet të ndryshojnë renditjen.

Përshkrimi i shpjegimit që opinionin e kundërt nuk është i mjaftueshëm, për një numër të arsyeve. E para, çështja nuk është kuantifikuar. Paragrafi duhet të theksoj shumën prej €10.5 milion dhe të deklaroj se kjo është materiale për pasqyrat financiare.

Paragrafi nuk thotë nëse plani pensional është në tepricë apo mungesë, dmthë a është pasuri apo detyrim i cili nuk është përfshirë në pasqyrat financiare.

Nuk ka përshkrim për ndikimin e shmangies në pasqyrat financiare. Psh. 'nëse do të njihej mungesa/ deficit, totali i detyrimeve do të ishte rritur për €10.5 milion, dhe ekutieti do të ishte zvogëluar me shumën e njëjtë.'

Nuk është e qartë nëse kontabiliteti për planin pensional ka ndodhur apo jo. Nuk i është bërë standardit relevant për pensionet, SNK 19. Referenca duhet të behet për ti ndihmuar përodruesit të kuptojnë se ka pasur shkelje të standardeve të kontabilitetit.

Përdorimi i fjalës 'i qëllimshëm' kur përshkruhet shmangia e planit pensional, nuk është profesionale, tingëllon akuzues dhe mund të mos jetë e saktë. Plani mund të jetë shmangur si

pasojë e gabimit dhe mund të jetë sugjeruar korigjimi i PF i cili ndoshta është duke u rishikuar nga menaxhmenti.

Në fund, ka pak gjasa që vetëm kjo çështje e vetme të rezultoj më opinion të kundërt. SNA 705 deklaron se opinioni i kundërt duhet të jepet vetëm nëse çështja është materiale dhe përhapëse për pasqyrat financiare. Shuma e deficitit prandaj edhe detyrimin që duhet të njihet është €10.5 milion e cila paraqet 6% të pasurive totale. Shuma është materiale por nuk do të konsiderohej si përhapëse për PF.

*Shënim: Zgjidhja e pjesës për lidhur me formatin e raportit të auditorit është paraqitur sipas standardit të parashikuar ISA 700. Nëse studentet kanë dhënë përgjigje sipas ISA 700 të rishikuar do të merren parasysh gjatë kontrollit të provimit*